

VENDIM
Nr. 629, datë 25.9.2019

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË BOSNJËS DHE HERCEGOVINËS DHE QEVERIVE TË VENDEVE TË TJERA
ANËTARE TË INICIATIVËS SË GATISHMËRISË DHE PARANDALIMIT TË
FATKEQËSIVE PËR EVROPËN JUGLINDORE, MBI MARRËVESHJET E
VENDIT PRITËS, PËR SEKRETARIATIN E INICIATIVËS SË GATISHMËRISË
DHE PARANDALIMIT TË FATKEQËSIVE PËR EVROPËN JUGLINDORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës dhe qeverive të vendeve të tjera anëtare të Iniciativës së Gatishmërisë dhe Parandalimit të Fatkeqësive për Evropën Juglindore, mbi marrëveshjet e vendit pritës, për Sekretariatin e Iniciativës së Gatishmërisë dhe Parandalimit të Fatkeqësive për Evropën Juglindore, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË BOSNJËS DHE HERCEGOVINËS DHE
QEVERIVE TË VENDEVE TË TJERA ANËTARE TË INICIATIVËS SË
GATISHMËRISË DHE PARANDALIMIT TË FATKEQËSIVE PËR EVROPËN
JUGLINDORE MBI MARRËVESHJET E VENDIT PRITËS
PËR SEKRETARIATIN E INICIATIVËS SË GATISHMËRISË DHE PARANDALIMIT TË
FATKEQËSIVE PËR EVROPËN JUGLINDORE

Këshilli i Ministrave i Bosnjës dhe Hercegovinës dhe palët e tjera anëtare të Iniciativës së Gatishmërisë dhe Parandalimit të Fatkeqësive për Evropën Juglindore: Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveritë e Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Malit të Zi, Rumanisë, Republikës së Sllovenisë, Republikës së Serbisë, Republikës së Turqisë (në vijim të referuara si “Palët e IGFP EJJL-së”):

Duke njohur përpjekjet që Palët e IGFP EJJL-së investojnë në krijimin e një bashkëpunimi më të afërt rajonal dhe të vendosura për të rritur zotërimin rajonal, nën kujdesin politik të procesit të SEECp-së, në kuadër të mbështetjes së Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal;

Bazuar në angazhimet e ndërmarra në Memorandumin e Mirëkuptimit për kuadrin institucional të Iniciativës së Gatishmërisë dhe Parandalimit të Fatkeqësive për Evropën Juglindore, të nënshkruar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe nga qeveritë e Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Malit të Zi, Republikës së Serbisë, Republikës së Sllovenisë dhe Republikës së Turqisë në Sarajevë, më 28 nëntor 2013 dhe nga Këshilli i Ministrave i Bosnjës dhe Hercegovinës në Sarajevë, më 18 prill 2014 dhe nga Qeveria e Rumanisë në Sarajevë, më 19 nëntor 2015;

Duke rikujtuar se Memorandumi i Mirëkuptimit për kuadrin institucional të Iniciativës së Gatishmërisë dhe Parandalimit të Fatkeqësive për Evropën Juglindore (2013) përcakton se selia e Sekretariatit të IGPF EJL-së ndodhet në Sarajevë, Bosnjë dhe Hercegovinë;

Duke njohur angazhimet e shprehura të palëve të IGPF EJL-së për të mbështetur zotërimin e plotë rajonal, i cili do të inkurajonte më tej partnerët ekzistues dhe të rinj për t'u përfshirë në bashkëpunimin politik dhe teknik rajonal në fushën e gatishmërisë dhe parandalimit ndaj fatkeqësive;

Duke dëshiruar që të rregullojnë statusin ligjor, privilegjet dhe imunitetet e nevojshme për funksionimin dhe realizimin me sukses të misionit të Sekretariatit të IGPF EJL-së.

Kanë rënë dakord si më poshtë:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Përkufizimet

Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje:

- a) **“Këshilli i Ministrave”** nënkupton Këshillin e Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës;
- b) **“Ekspert”** nënkupton një person që kryen mision të përkohshëm për Sekretariatin ndryshe nga sa është parashikuar sipas paragrafëve “e” dhe “g” të këtij neni dhe mund të përfshijë personelin e dërguar prej palëve të IGPF EJL-së ose praktikantët;
- c) **“Shefi i Sekretariatit”** është personi i emëruar si shef i Sekretariatit të IGPF EJL-së në Sarajevë;
- d) **“Vendi Pritës”** është Bosnja dhe Hercegovina;
- e) **“Anëtar i personelit të Shërbimit Vendor”** nënkupton punonjësit që ofrojnë shërbime mbështetëse për Sekretariatin, të tillë si administrator i rrjetit të internetit, shofer, punonjës pastrimi;
- f) **“Memorandum Mirëkuptimi”** nënkupton Memorandumin e Mirëkuptimit të kuadrit institucional të Iniciativës së Gatishmërisë dhe Parandalimit të Fatkeqësive dhe për Evropën Juglindore, të nënshkruar më 28 nëntor 2013, në Sarajevë;
- g) **“Zyrtar”** nënkupton një anëtar të personelit të Sekretariatit për të cilin është njoftuar Ministria e Punëve të Jashtme të vendit pritës, i cili kryen detyrat për Sekretariatin me kohë të plotë, të ndryshme nga ato në bazë të paragrafit “e” të këtij neni;
- h) **“Ambientet e Sekretariatit”** nënkupton godinën, duke përfshirë tokën e saj ndihmëse, të zënë nga Sekretariati dhe të përdorur vetëm për qëllimet e Sekretariatit, pavarësisht nga pronësia;
- i) **“Përfaqësues”** nënkupton përfaqësuesin e autorizuar të Palës së IGPF EJL-së ose partnerë të tjerë të IGPF EJL-së; dhe
- j) **“Sekretariat”** nënkupton Sekretariatin e IGPF EJL-së.

Neni 2

Selia

1. Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është që të mundësojë Sekretariatin për të kryer detyrat dhe funksionet e tij operationale në mënyrë efikase nëpërmjet Selisë të Sekretariatit.

2. Në përputhje me nenin 7, paragrafin 1, të Memorandumit të Mirëkuptimit, Selia e Sekretariatit ndodhet në Sarajevë, Bosnjë dhe Hercegovinë.

Neni 3

Statusi ligjor

1. Sekretariati do të ketë personalitet juridik dhe zotësinë juridike të nevojshme për kryerjen e funksioneve të tij, si për të lidhur kontrata, për të marrë dhe disponuar pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme dhe për të vendosur procedurat ligjore në përputhje me legjislacionin e vendit pritës.

2. Autoritetet kompetente të vendit pritës do të ndihmojnë Sekretariatit në procedurën e marrjes së dokumenteve përkatëse për rregullimin e statusit juridik të Sekretariatit, në mënyrë që statusi të merret brenda 60 ditëve nga nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4

Kontributet e lidhura me zyrën nga vendi pritës

1. Këshilli i Ministrave do t'i japë Sekretariatit për kohëzgjatjen e kësaj Marrëveshjeje, pa asnjë tarifë, lehtësirat e nevojshme, duke përfshirë mjediset e përshtatshme dhe të duhura në Sarajevë për kryerjen efektive të funksioneve të tij.

2. Ambientet, duke përfshirë pajisjet, orenditë dhe shërbimet, do të jenë në dispozicion pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5

Rregulloret e brendshme të Sekretariatit

Sekretariati mund të nxjerrë rregullore të brendshme të nevojshme në lidhje me zbatimin dhe organizimin e funksioneve të tij, në përputhje me Memorandumin e Mirëkuptimit ose çdo rregullim tjetër të brendshëm të zbatueshëm.

Neni 6

Identiteti vizual

1. Sekretariati mund shfaqë artikuj identiteti vizual të IGPF EJL-së (p.sh.: flamur, logo), të miratuar nga IGPF EJL, në ambientet e saj dhe në automjete të përdorura për qëllime zyrtare.

2. Mjetet motorike që i përkasin Sekretariatit kanë të drejtë për targa të regjistruara diplomatike dhe të statusit të duhur.

Neni 7

Liria e operacioneve të Sekretariatit

Vendi pritës do t'i garantojë Sekretariatit një liri të operacioneve.

Neni 8

Paprekshmëria

1. Ambientet e Sekretariatit janë të paprekshme. Autoritetet kompetente të vendit pritës do të kenë të drejtën për të hyrë në ambientet e Sekretariatit, në mënyrë që të kryejnë detyrat e tyre, vetëm me pëlqimin e Shefit të Sekretariatit ose zyrtarëve të Sekretariatit, ose të zyrtarëve të autorizuar në mënyrën e duhur, sipas kushteve të rëna dakord nga ana e tyre.

2. Këshilli i Ministrave do të marrë të gjitha masat për të mbrojtur ambientet Sekretariatit kundër çdo ndërhyrjeje apo dëmi, dhe për të parandaluar dëmtimin e dinjitetit të tij.

3. Regjistrimet dhe arkiva e Sekretariatit, si dhe i gjithë dokumentacioni (duke përfshirë programet kompjuterike dhe fotografi) që i përkasin apo janë në pronësi të tij, janë të paprekshme.

Neni 9

Përfshirja nga procedurat gjyqësore dhe ekzekutimet

1. Sekretariati do të gëzojë përjashtimin nga procedurat gjyqësore dhe ekzekutimet në vendin pritës, me përjashtim të rasteve:

a) kur organi kompetent i IGFP EJJL-së ka autorizuar heqjen dorë nga imuniteti nga procesi gjyqësor. Heqja e imunitetit nga proceset gjyqësore nuk do të nënkuptojë heqjen dorë në lidhje me ndonjë masë të ekzekutimit ose ndalimit të pronës;

b) kundërpaditë në lidhje të drejtpërdrejtë me procedurën e filluar nga Sekretariati;

c) çdo marrëveshje për blerjen e mallrave dhe shërbimeve, çdo hua apo transaksion tjetër për të siguruar financim, si dhe çdo marrëdhënie garancie ose dëmshpërblimi në lidhje me ndonjë transaksion të tillë ose detyrim tjetër financiar;

d) Padi civile e filluar nga një palë e tretë për shkak të vdekjes, dëmit material ose lëndimeve personale për shkak të shkeljeve të rregullave të trafikut të mjeteve motorike, nga mjete motorike që i përkasin apo përdoren në emër të Sekretariatit; dhe

e) mosmarrëveshjet e punës.

2. Sekretariati, në lidhje me pronën e tij të luajtshme dhe të paluajtshme, kudo që ndodhet dhe nga kushdo që mbahet në vendin pritës, përjashtohet nga çdo masë e ekzekutimit, duke përfshirë konfiskimin, eliminimin, ngrirjen ose ndonjë formë tjetër të ekzekutimit ose sekuestrimit, ose ndonjë privim tjetër të pasurisë të parashikuar nga ligjet e vendit pritës.

Neni 10

Komunikimi

1. Sekretariatit, në lidhje me komunikimin e tij zyrtar, duhet t'i jepet i njëjti trajtim që është dhënë për misionet diplomatike në vendin pritës.

2. Sekretariati mund të përdorë të gjitha mjetet e duhura të komunikimit. Ai do të ketë të drejtën për të dërguar dhe marrë korrespondencë me anë të korrierëve të identifikuar siç duhet ose në paketa të cilave do t'u jepen të njëjtat privilegje dhe gëzojnë përjashtime si korrierë diplomatikë ose paketa diplomatike.

3. Korrespondenca zyrtare dhe komunikimi tjetër zyrtar i Sekretariatit, kur identifikohet siç duhet, nuk do të censurohet.

Neni 11

Publikimet

Importi dhe eksporti i botimeve për nevojat e Sekretariatit, si dhe materialet e tjera informuese që importon Sekretariati ose eksportet në kuadër të aktiviteteve të tij zyrtare, nuk i nënshtrohen kufizimeve të çdo lloji.

Neni 12

Shërbimet publike

1. Autoritetet kompetente të vendit pritës do të jenë të detyruara që, me kërkesën e Sekretariatit dhe në kushte të drejta, të ofrojnë shërbime publike për Sekretariatin, për të cilat ai ka nevojë në mënyrë që të kryejë funksionet e tij, duke përfshirë, por pa u kufizuar në shërbimet postës, telefon, energji elektrike, ujë, kanalizim, gaz, shërbime të grumbullimit të mbetjeve dhe mbrojtjen kundër zjarrit.

2. Çmimet për shërbimet publike sipas paragrafit 1 të këtij neni, të cilat nuk i nënshtrohen nenit 4, paragrafi 2, nuk duhet të tejkalojnë çmimet më të ulëta të krahasueshme të miratuara në misionet diplomatike në vendin pritës.

3 Në rast të përfundimit apo marrjes së të dhënave për ndërprerje të shërbimeve të lartpërmendura publike, Sekretariatit do t'i jepet i njëjti prioritet si për misionet diplomatike, për kërkesa të funksioneve të tij zyrtare.

4. Me kërkesën e autoriteteve kompetente të vendit pritës, kryetari i Sekretariatit do të jetë përgjegjës për të siguruar përfaqësuesit e autorizuar në mënyrën e duhur të shoqërive të shërbimeve publike për të kontrolluar, riparuar, mirëmbajtur dhe zhvendosur instalimet në ambientet e Sekretariatit, në kohën e duhur, në kushte që nuk do të ndikojnë në funksionimin e Sekretariatit.

Neni 13

Përrjashtimi nga detyrimet dhe taksat

1. Sekretariati, fondet e tij, të ardhurat dhe pronat e tjera do të përjashtohen nga çdo detyrim dhe taksë e drejtpërdrejtë. Ky përjashtim nuk zbatohet për tatimet dhe ndarjet buxhetore që konsiderohen taksa të shërbimeve publike të ofruara me çmime fikse, në përputhje me sasinë e shërbimeve të ofruara, të cilat mund të identifikohe, të përshkruara dhe të ndara.

2. Në kushtet e tatimit mbi vlerën e shtuar (në vijim i referuar si "TVSH") të përfshirë në çmime ose të llogaritur veçmas, përjashtimi do të zbatohet vetëm mbi sendet e fituara për përdorimin zyrtar të Sekretariatit, ndërsa mallrat e blera për përdorimin e saj, për të cilat zbatohen përjashtime në përputhje me këtë dispozitë, nuk duhet të shiten, jepen si dhuratë ose privohen në ndonjë mënyrë tjetër, përveç në përputhje me kushtet e rëna dakord me Këshillin e Ministrave.

3. Sekretariati do të përjashtohet nga të gjitha vlerat ose tarifat shtetërore dhe vendore, përveç normave të tarifave ose të llogaritura si çmimet e shërbimeve të kryera realisht.

4. Përjashtimi nga TVSH-ja, i përmendur në paragrafin 2 të këtij neni, si dhe më pas në nenin 17, paragrafi 1, pika "d", dhe në nenin 18, paragrafi 1, pika "d" do të realizohet nëpërmjet të drejtës për rimbursim të TVSH-së.

Neni 14

Përrjashtimi nga dogana

Mallrat e importuara apo të eksportuara për qëllim të përdorimit zyrtar nga Sekretariati do të përjashtohen nga pagesa e doganës, tatimeve dhe taksave.

Neni 15

Disponimi i lirë i fondeve dhe liria e biznesit

Sekretariati, për qëllim të përmbushjes së funksioneve të tij, ka të drejtë të marrë, mbajë, konvertojë dhe transferojë të gjitha fondet, monedhat, të hollat dhe vlerat e tjera të transferueshme, dhe t'i disponojë lirisht dhe të kryejë biznes pa kufizime, në përputhje me legjislacionin e vendit pritës.

Neni 16

Sigurimet shoqërore

Shefi i Sekretariatit, zyrtarët dhe ekspertët, të cilët nuk janë qytetarë të vendit pritës apo rezidentë të përhershëm, do të përjashtohen nga pagesa e kontributeve të detyrueshme në lidhje me çdo lloj të sigurimit shoqëror në vendin pritës.

Neni 17

Shefi i Sekretariatit dhe zyrtarët

1. Shefi i Sekretariatit dhe zyrtarët në vendin pritës gëzojnë privilegjet dhe imunitetet e mëposhtme në vendin pritës:

a) imunitet nga procesi gjyqësor në lidhje me fjalët e thëna apo të shkruara, si dhe për të gjitha veprimet e kryera prej tyre në cilësinë e tyre zyrtare, edhe pasi të pushojnë së qeni zyrtarë të Sekretariatit;

b) imunitet prej kërkimit dhe konfiskimit të bagazheve të tyre personale;

c) paprekshmëri të dokumenteve zyrtare, të dhënave dhe materialeve të tjera;

d) përjashtim nga taksat, duke përfshirë TVSH-në, kontributet për pagat, shpërblimet dhe kompensimet e paguara atyre nga ana e Sekretariatit për shërbimet e tyre;

e) përjashtim nga kufizimet e emigracionit dhe detyrimi për të regjistruar veten dhe anëtarët e familjeve të tyre që janë pjesëtarë të familjes së tyre përkatëse me të cilët ata jetojnë;

f) të njëjtën mbrojtje dhe lehtësira riatdhesimi për vete dhe anëtarët e familjeve të tyre që janë pjesë e familjeve të tyre përkatëse, siç u janë dhënë zyrtarëve të rangjeve të krahasueshme në misionet diplomatike; dhe

g) të drejtën për të importuar për qëllimin e tyre personal, pa tatim importi dhe taksa ose detyrime të tjera, me kusht që këto tarifa të mos caktohen për ofrimin e shërbimeve publike, si dhe përjashtim nga kufizimet e importit dhe kufizimet e importit dhe eksportit për;

i. orënditë dhe sendet e tyre personale në kohën kur fillojnë detyrën në funksionin e tyre, në një ose më shumë dërgesa individuale; dhe

ii. një mjet motorik çdo katër vjet.

2. Mënyra në të cilën mallrat e importuara do të disponohen, me përjashtim nga pagesa e detyrimeve të importit, do të zbatohet në përputhje me rregulloret për tatimet, taksat dhe shumat e tjera, për cilat kanë të drejtë zyrat e huaja diplomatike dhe konsullore përfaqësuese në vendin pritës.

Neni 18 **Ekspertët**

Ekspertët do të gëzojnë privilegjet dhe përjashtimet e mëposhtme në vendin pritës:

a) përjashtimi nga procedurat gjyqësore në lidhje me fjalët e folura apo të shkruara, si dhe të gjitha aktet e kryera prej tyre në përmbushjen e funksioneve të tyre zyrtare, edhe pasi të pushojnë së qeni ekspertë të Sekretariatit;

b) përjashtimi nga kontrolli dhe sekuestrimi i bagazheve personale dhe zyrtare;

c) paprekshmëria e dokumentacionit zyrtar, të dhëna dhe materiale të tjera; dhe

d) përjashtimi nga taksat, duke përfshirë TVSH-në, kontributet mbi pagat, përfitimet shtesë dhe dëmshpërblimet që u paguhen atyre nga ana e Sekretariatit për shërbimin e tyre, në pajtim me legjislacionin e zbatueshëm të vendit pritës.

Neni 19 **Përfaqësuesit**

Përfaqësuesit do të gëzojnë përjashtimet e mëposhtme gjatë periudhës së kryerjes së përgjegjësi të tyre në vendin pritës, si dhe gjatë qëndrimit të tyre në territorin e vendit pritës:

a) përjashtim nga procedurat gjyqësore në lidhje me fjalët e folura apo të shkruara, si dhe të gjitha aktet e kryera prej tyre në përmbushjen e funksioneve të tyre zyrtare, edhe pasi të pushojnë së qeni përfaqësues;

b) përjashtim nga kontrolli dhe sekuestrimi i bagazheve personale;

c) paprekshmëri e dokumentacionit zyrtar, të dhënave dhe materialeve të tjera; dhe

d) përjashtim nga kufizimet e emigracionit.

Neni 20

Qytetarët e vendit pritës dhe banorët e përhershëm

Shefi i Sekretariatit, zyrtarët dhe ekspertët, të cilët janë shtetas të vendit pritës ose me qëndrim të përhershëm nuk do të kenë të drejtë për privilegjet dhe imunitetet të përmendura në nenin 17, paragrafi 1, pikat “a”, “b”, “c” dhe “d”, të kësaj Marrëveshje.

Neni 21

Stafi vendor i shërbimit

Sekretariati do të ketë të drejtën për të marrë personel të shërbimit vendor në përputhje me legjislacionin e vendit pritës.

Neni 22

Qëllimi i privilegjeve dhe përjashtimet

1. Privilegjet dhe imunitetet sipas kësaj Marrëveshjeje janë dhënë në interes të Sekretariatit dhe jo për përfitime personale të vetë individëve.

2. Qëllimi i tyre është vetëm për të siguruar lirinë e veprimeve të Sekretariatit në të gjitha rrethanat, si dhe pavarësinë e plotë të personave të përmendur në kryerjen e detyrave të tyre për Sekretariatin.

Neni 23

Njoftimi

1. Sekretariati do të njoftojë në Ministrinë e Punëve të Jashtme të vendit pritës në lidhje me emrat e shefit të Sekretariatit dhe zyrtarëve, si dhe të anëtarëve të familjeve të tyre menjëherë ose brenda maksimumi pesë ditësh pune nga data e mbërritjes së tyre. Sekretariati do të njoftojë përfundimin e mandatit të Kryetarit të Sekretariatit ose të çdo zyrtari, si dhe kur është e nevojshme, faktin që një person pushon së qeni anëtar i familjes së tyre.

2. Shefit të Sekretariatit dhe Zyrtarët, si dhe anëtarëve të familjeve të tyre, të cilët nuk janë shtetas ose me banim të përhershëm në vendin pritës, duhet t'u jenë lëshuar kartat e duhura të identitetit nga Ministria e Punëve të Jashtme e vendit pritës.

3. Sekretariati nuk duhet të njoftojë në Ministrinë e Punëve të Jashtme në lidhje me emrat e Ekspertëve. Ekspertët do t'i nënshtrohen kufizimeve dhe detyrimeve të imigracionit për t'u regjistruar në Shërbimin për Çështjet e të Huajve në Ministrinë e Sigurisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi të vendit pritës.

Neni 24

Mosmarrja e përgjegjësisë nga ana e vendit pritës

Vendi pritës nuk do të marrë asnjë përgjegjësi ndërkombëtare për veprimet apo mosveprimet nga ana e Sekretariatit në territorin e tij.

Neni 25

Çështjet e sigurisë

1. Asgjë në këtë Marrëveshje nuk përjashton të drejtën e Këshillit të Ministrave të vendit pritës për të zbatuar të gjitha masat e duhura të mbrojtjes në interes të sigurisë publike. Asgjë në këtë Marrëveshje nuk do të pengojë zbatimin e ligjeve të vendit pritës, të nevojshme për vendosje të shëndetit ose rendit publik.

2 Nëse Këshilli i Ministrave i vendit pritës e çmon të nevojshme zbatimin e dispozitave të paragrafit 1 të këtij neni, dhe sa më shpejt që e lejojnë rrethanat, ai do të lidhet me Sekretariatit për të marrë një vendim të përbashkët mbi masat që mund jenë të nevojshme për të mbrojtur interesat e Sekretariatit.

3. Sekretariati është i detyruar të bashkëpunojë me autoritetet e vendit pritës, në mënyrë që të parandalohet çdo pengesë e sigurisë publike për shkak të një aktiviteti të kryer nga ana e Sekretariatit.

II. DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 26

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Të gjitha mosmarrëveshjet në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhen nëpërmjet konsultimeve dhe bisedimeve ndërmjet palëve të IGPF EJL-së.

Neni 27

Ndryshimet

1. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet nëpërmjet propozimit me shkrim të çdo pale të IGPF EJL-së.

2. Çdo propozim i tillë duhet t'i komunikohet nga Depozitari të gjitha palëve të IGPF EJL-së.

3. Palët e IGPF EJL-së do të njoftojnë depozitarin sa më shpejt të jetë e mundur për miratimin e tyre të amendamenteve të propozuara.

4. Amendamentet e miratuara me konsensus, në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni, do të hyjnë në fuqi në përputhje me nenin 28 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 28

Hyrja në fuqi dhe zbatimi i përkohshëm

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e parë të muajit pasardhës nga data e marrjes së njoftimit të gjashtë të palëve të IGPF EJL-së nga depozitari, duke përfshirë vendin pritës, për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme ligjore, të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Për çdo Palë të IGPF EJL-së që njofton Depozitarin për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme ligjore, të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, kjo Marrëveshjeje, do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit nga data e marrjes së njoftimit të asaj pale të IGPF EJL-së nga Depozitari.

3. Kjo marrëveshje do të zbatohet përkohësisht nga data e nënshkrimit të saj, për sa kohë që një Palë e IGPF EJL-së nuk deklaron në momentin e nënshkrimit të saj që kërkesat e saj të brendshme ligjore nuk lejojnë këtë zbatim të përkohshëm. Për të gjitha këto Palë të IGPF EJL-së, Marrëveshja do të hyjë në fuqi në datën e njoftimit të tyre te Depozitari.

Neni 29

Aderimi

Me hyrjen e saj në fuqi, kjo Marrëveshjeje do të jetë e hapur për çdo palë të IGPF EJL-së që aderon në Memorandumin e Bashkëpunimit në përputhje me nenin 13 të saj. Për palën që aderon, kjo marrëveshjeje do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit pas datës së depozitimit të instrumentit të aderimit te Depozitari.

Neni 30

Kohëzgjatja dhe përfundimi

1. Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi për aq kohë sa edhe Memorandumi i Mirëkuptimit është në fuqi.

2. Këshilli i Ministrave i vendit pritës ka të drejtë të denoncojë këtë Marrëveshje, duke njoftuar palët me shkrim. Në këtë rast, kjo Marrëveshje do të përfundojë 6 (gjashtë) muaj nga marrja e këtij njoftimi.

3. Çdo Palë e IGPF EJJL-së mund të denoncojë këtë Marrëveshje, duke njoftuar me shkrim depozitarin. Në këtë rast, kjo Marrëveshje do të pushojë së qeni në fuqi për atë Palë të IGPF EJJL-së, ditën e parë të muajit, nga data e pranimit të njoftimit nga Depozitari.

4. Denoncimi nga Memorandumi i Mirëkuptimit, në përputhje me nenin 15, paragrafin 2, duhet të konsiderohet si denoncim i kësaj Marrëveshjeje. Në këtë rast, kjo Marrëveshje do të ndërpritet për palën e IGPF EJJL-së në fjalë, nga data kur denoncimi i Memorandumit të Mirëkuptimit do të hyjë në fuqi për atë palë të IGPF EJJL-së.

Neni 31 **Depozitari**

1. Këshilli i Ministrave i Bosnjë dhe Hercegovinës do të veprojë si depozitar i kësaj Marrëveshjeje.

2. Originali i kësaj Marrëveshjeje do të depozitohet pranë depozitarit, i cili do t'u mundësojë palëve të IGPF EJJL-së dhe Sekretariatit kopje të vërtetuara të saj.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit e autorizuar sipas rregullave nga qeveritë e tyre përkatëse, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në Ankara, më 4 prill 2018, në një origjinal në gjuhën angleze.

Në emër të Qeverisë së Republikës së Bullgarisë

.....

Në emër të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë

.....

Në emër të Qeverisë së Republikës së Sllovenisë

.....

Në emër të Qeverisë së Republikës së Turqisë

.....

Bërë në Sarajevë, më 4 korrik 2018

Në emër të Qeverisë së Republikës së Kroacisë

.....

Në emër të Qeverisë së Malit të Zi

.....

Në emër të Qeverisë së Rumanisë

.....

Në emër të Qeverisë së Republikës së Serbisë

.....

Bërë në Tiranë, më 20 shtator 2018

Në emër të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë

.....

Bërë në Sarajevë, më 19 nëntor 2018

Në emër të Këshillit të Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës

.....